



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
RREGULLATORNI URED ZA ENERGIJU

Nr. 101/124  
Data: 06.02.24

Prishtinë, 29 janar 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1840\_2024

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së;
- Nenin 3, 4, 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtritshme të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 30 kW në Komunën e Graçanicës, e pranuar me datë 09.01.2024 nga aplikuesi personi juridik "Medical Group" SH.P.K., me adresë: "Livagjë" Komuna e Graçanicës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 29 janar 2024 nxori këtë:

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. APROVOHET** - kërkesa dhe miratohet Statusi i Prosumatorit aplikuesit "Medical Group" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 30 kW në Komunën e Graçanicës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "Medical Group" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE – 9033718 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi "Medical Group" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me Nenin 7 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtritshme.


**A r s y e t i m**



- ZRRE, me datë 09.01.2024 nga aplikuesi "Medical Group" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 30 kW në Komunën e Graçanicës.
  - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 11146 të datës 12.12.2023 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. II. 1510/23 të datës 31.07.2023 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Graçanicës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "Medical Group" SH.P.K., dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për marrjen e statusit të prosumtorti dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej 30 kW në Komunën e Graçanicës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtare

  
Gani Buçaj, anëtar

  
Arta Qorolli, anëtare

  
Anan Preniqi, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Graçanicës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.